

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSÇËM I APELIMIT
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

RAPORT

MBI

**MONITORIMIN E FONDEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR – GUSHT 2024
PËR KOLEGJIN E POSÇËM TË APELIMIT**

SHTATOR 2024

PËRMBAJTJA

1	Hyrje.....	3
2	Raporti i shpenzimeve faktike për vitin 2024.....	4
	2.1 Informacion mbi volumin dhe madhësinë e ndryshimit të buxhetit	5
	Analiza financiare analitike	6
	2.1.1 Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)	6
	2.1.2 Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601).....	6
	2.1.3 Shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera (llogaria ekonomike 602)	7
	2.1.4 Shpenzimet kapitale (231).....	9
3	Aneks 1 situacion i shpenzimeve operative 602 për 8-mujorin e parë të vitit 2024.....	90

1 HYRJE

Ky dokument përfaqëson raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuara që ka në fushën e përgjegjësisë Kolegji i Posaçëm i Apëlimit (Kolegji). Ky dokument ofron informacion të detajuar mbi ecurinë e zbatimit të buxhetit dhe mbulon periudhën 1 janar 2024 deri më 31 gusht 2024. Monitorimi i zbatimit të buxhetit për periudhën 1 janar deri më 31 gusht 2024, për Kolegjin përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. Strukturat e Kolegjit kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë me qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar në përputhje me planin e ecurisë së institucionit dhe të gjitha kërkesave ligjore. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi, evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të Kolegjit në krahasim me planin e miratuar, të detajuar në nivel treguesish të performancës.

Analiza e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor i mundëson institucionit orientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë, për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Me qëllim për të kontribuar në proceset bazë të misionit dhe objektivave të institucionit, buxheti i Kolegjit është mbështetur plotësisht në udhëzimet standarde të hartimit të buxhetit mbi bazë të treguesve të performancës, por gjithashtu dhe monitorimin e realizimit buxhetor mbështetur mbi ato tregues të planifikuar gjatë hartimit të programit buxhetor afatmesëm.

Ky raport zyrtar do të shërbejë si një pasqyrë e rëndësishme përmes së cilës Kolegji do të synojë lidhjen e kostove buxhetore me produktet e performancës, si forma më e mirë e buxhetimit dhe vlerësimit financiar të ecurisë së institucionit. Forma dhe përmbajtja e raportit të monitorimit u krye sipas Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.

Ekipi i Menaxhimit të Programit “Veprimtaria e apëlimit të rivlerësimit kalimtar” gjatë përgatitjes së raportit zhvilloi komunikime intensive me strukturat përgjegjëse të Kolegjit, me qëllim paraqitjen e drejtë dhe të qartë të arritjeve dhe problematikave të hasura gjatë periudhës raportuese.

Misioni i Kolegjit është: Përbushja e funksioneve dhe kompetencave ligjore për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut, tek institucionet e këtij sistemi.

Objektivi i Kolegjit është: Të shqyrtojë çështjet e ankimuarra nën juridiksion, bazuar në një proces të rregullt ligjor.

Mbulimi i prioriteteve të institucionit me fondet e mjaftueshme buxhetore është një synim, i cili do të sigurojë institucionit qëndrueshmërinë dhe integritetin e nevojshëm për arritjen e rezultateve të sipërcituara. Mund të ekzistojë një mospërputhje jomateriale ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur nëpër tabela dhe grafikë për shkak të rumbullakimeve. Vlerat e plota paraqiten në anekset bashkëngjitur këtij raporti.

Kolegji, për përbushjen e misionit të tij, për vitin 2024, administron dhe menaxhon fondet publike, në bazë të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 97/2023, të ndryshuar, datë 07.12.2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe në bazë të akteve normative të dala gjatë vitit apo Vendimeve të Këshillit të Ministrave.

2 RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE PËR VITIN 2024

Buxheti i Kolegjit është miratuar me ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, ku në total rezulton të jetë planifikuar si plan fillestar një vlerë prej 248,900,000 lekë. Këto burime financiare, Kolegji i ka përdorur në funksion të përmbushjes së plotë të detyrimeve të miratuara me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe vendimmarrjes së Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 02, datë 09.02.2024 për detajimin e fondeve buxhetore për vitin 2024.

Gjatë periudhës 8 mujore të vitit 2024, në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave, nr.01, “Për zbatimin e buxhetit 2024”, datë 24.01.2024, është miratuar fondi i veçantë, i cili u çel në fillim të vitit në vlerën 250,000 lekë si dhe është transferuar një buxhet prej 1,000,000 lekë nga artikulli 602 “Mallra dhe Shërbime të Tjera”, në artikullin 606 “Transferta për Buxhete familjare dhe individë”. Si rrjedhim i kësaj, plani i rishikuar vjetor rezulton të jetë 249,150,000 lekë.

Në kërkesat buxhetore për vitin 2024 Kolegji i Posaçëm i Apelit ka përcaktuar si produkt kryesor në realizimin e objektivit, “Çështje të ankimuar/shqyrtuara”, me një plan vjetor në masën prej 70 çështje. Deri më 31.08.2024 janë realizuar 41 çështje. Në këtë parashikim është përfshirë numri i ankimeve që parashikohet të paraqiten gjatë vitit 2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të Juridiksionit të Rivlerësimit (JR), si dhe numri i ankimeve/kërkesave në kuadër të Juridiksionit Disiplinor (JD).


Deri në fund të muajit gusht 2024, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin, paraqitet si më poshtë:

RAPORTI I SHPENZIMEVE TË PROGRAMEVE SIPAS LLOGARIVE EKONOMIKE

<i>në mijë lekë</i>					
<i>Art.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Fakt 2023</i>	<i>Buxhet fillestar 2023 sipas ligjit 97/2023</i>	<i>Buxhet rishikuar 2024</i>	<i>Fakt deri 31.08.2024</i>
600	Paga	233,692	203,100	203,100	143,169
601	Sigurime Shoqërore	17,721	20,160	20,160	13,245
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	11,720	23,640	22,640	5,568
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	889		1,250	441
230/231	Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	954	2,000	2,000	0
	Total	264,976	248,900	249,150	162,423

Pesha specifike sipas llogarive ekonomike të shpenzimeve të planifikuara mbi totalin e shpenzimeve, paraqitet sipas figurës të mëposhtme:

STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA VS. REALIZIMIT 2024



Duke marrë në analizë peshën e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike mbi totalin e buxhetit të Kolegjit, ashtu siç mund të konstatohet në figurën më lart, pjesën më të madhe të planit të shpenzimeve buxhetore e zë llogaria “Paga të personelit” me rreth 88%, pas saj vjen llogaria “Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” me rreth 8%, më pas llogaria “Mallra dhe shërbime të tjera” me rreth 3%, ndërkohë që llogaria “Shpenzime kapitale” zë një peshë më të vogël, rreth 1%.

Duke u mbështetur mbi veprimtarinë bazë të institucionit, kjo shpërndarje e planit të shpenzimeve buxhetore lidhet drejtpërdrejtë me natyrën e punës së Kolegjit.

Nëse do të marrim në analizë peshën e llogarive ekonomike, ndërmjet atyre të planifikuara dhe të realizuara sipas figurës të mësipërme, evidentohet një ruajtje e peshës së këtyre shpenzimeve, si në buxhetin e planifikuar, ashtu edhe në atë të realizuar për vitin 2024.

Qëndrueshmëria financiare e institucionit dhe ndjekja me rigorozitet e procedurave të menaxhimit financiar publik, kanë udhëhequr veprimtarinë administrative të Kolegjit. Gjatë kësaj periudhe, e në vazhdim, synohet vijimi i konsolidimit financiar dhe administrativ i institucionit me qëllim arritjen plotësisht të realizimit buxhetor dhe treguesve të performancës, të përcaktuar në programin buxhetor afatmesëm 2024-2026.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024 do të vazhdohet të synohet përdorimi me eficiencë dhe efektivitet maksimal i burimeve financiare në raport me rritjen e nivelit të performancës së treguesve, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

2.1 INFORMACION MBI VOLUMIN DHE MADHËSINË E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT

Për vitin 2024, buxheti i miratuar sipas ligjit nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, udhëzimit plotësues të Ministrisë të Financave nr.1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, ishte në vlerën 248,900,000 lekë. Gjatë vitit, buxheti pësoi ndryshime, të cilat konsistojnë vetëm në shtesën e fondit të veçantë dhe transferimin e vlerës prej 1,000,000 lekë nga artikulli 602 “Mallra dhe Shërbime të Tjera”, në artikullin 606 “Transferata për Buxhete familjare dhe individë”. Tabela më poshtë paraqet planin e rishikuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore.

- Fondi i veçantë sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr. 534, datë 09.02.2024, protokolluar në Kolegj me nr. 145/1 prot., datë 13.02.2024;
- Transferim fondi sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr. 687/1, datë 09.02.2024, protokolluar në Kolegj me nr. 161/1 prot., datë 13.02.2024;

Rishikimi i fondeve buxhetore

në mijë lekë

<i>Llog.ekonomike</i>	<i>Plani fillestar (Ligji 97/2023)</i>	<i>Rialokim për shpenzimet celulare</i>	<i>Shtesa nga fond i vecante</i>	<i>Plan i rishikuar</i>
600	203,100	-	-	203,100
601	20,160	-	-	20,160
602	23,640	-1,000	-	22,640
606	-	1,000	250	1,250
231	2,000	-	-	2,000
Total	248,900	0	250	249,150

ANALIZA FINANCIARE ANALITIKE

Të analizuara sipas llogarive ekonomike analitike paraqiten:

2.1.1 Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)

Fondet e parashikuara për këtë zë, sipas planit të rishikuar vjetor janë në vlerën e 203.1 milionë lekë, të cilat janë realizuar në masën 70% e planit të rishikuar të vitit 2024. Buxheti për paga, i rishikuar, për vitin 2024, përbën 82% të buxhetit total vjetor, ndërsa realizimi për këtë artikull, zë 88% të buxhetit total të përdorur për 8-mujorin e parë. Realizimi në këtë masë është kryesisht rrjedhojë e numrit faktik, të strukturës organike të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Numri mesatar i punonjësve për 8-mujorin e parë të vitit 2024 është 62 punonjës.

Numri i punonjësve në organikë, i planifikuar për vitin 2024, ishte 57 punonjës dhe pas miratimit të strukturës së re, me vendimin 35/2024, datë 11.04.2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, ky numër arriti në 63 punonjës. Në fund të periudhës 8 mujore, numri faktik i punonjësve në Kolegj është 61 punonjës.

Sipas VKM-së nr. 39, datë 24.01.2024, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, në njësitë e qeverisjes qendrore” Kolegjit i është miratuar detajimi nga Ministria e Financave numri prej 7 punonjësish me kontratë të përkohshme, me kohë të pjesshme pune (6 orë/ditë), të cilët me miratimin e vendimit të Kuvendit nr. 35/2024, kanë kaluar me kohë të plotë. Aktualisht numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, pune është 1.

2.1.2 Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)

Fondet e parashikuara për këtë zë sipas planit të rishikuar vjetor janë në vlerën e 20,16 milionë lekë, të cilat janë realizuar në masën 66% e planit të rishikuar të vitit 2024. Buxheti i rishikuar për vitin 2024 përbën 8% të buxhetit total vjetor.

Fondi për kontributet e detyrueshme të sigurimeve është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit dhe në përpjesëtim të drejtë me shpenzimet për paga, si rrjedhojë argumentat që lidhen me fondin e pagave, vlejné edhe për këtë zë.

Plani i thesarit për 8-mujorin e parë të vitit 2024 për shpenzimet e personelit (artikulli 600 dhe 601) është realizuar në masën 89 % ose 156,4 milionë lekë nga 175,6 milionë lekë. Realizimi në këtë masë është kryesisht rrjedhojë e vakancave në strukturë të krijuara gjatë kësaj periudhe.

2.1.3 Shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera (llogaria ekonomike 602)

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për materiale dhe shërbime të domosdoshme për mbështetjen e veprimtarisë institucionale operacionale. Shpenzimet për këtë zë, zënë 9% të shpenzimeve totale vjetore.

Buxheti fillestar vjetor i miratuar ishte në vlerën e 23.6 milionë lekë dhe buxheti i rishikuar, pas transferimit të fondit në vlerë 1 milion lekë nga artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” në artikullin 606 “Transferata për buxhetet familjare dhe individët” për mbulimin e shpenzimeve telefonike për kontratat individuale të gjyqtarëve dhe këshilltareve të Kolegjit , bazuar në VKM-në nr. 855, datë 02.11.2020 dhe Vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 28, datë 21.12.2020, arriti në vlerën 22.6 milionë lekë.

Buxheti i detajuar në shpenzime operative, për 8-mujorin e parë të vitit 2024, është realizuar në vlerën 5.6 milionë lekë nga 22.6 milionë lekë të planifikuara, ose e thënë ndryshe në masën 25%

Në mënyrë të detajuar shpenzimet për mallra dhe shërbime paraqiten në tabelën në vijim.

Në aneksin nr.1 paraqitet e detajuar edhe nënlligari.

Në lekë

<i>N/artik</i>	<i>Struktura e llogarive</i>	<i>Plan vjetor</i>	<i>Fakt Progresiv 4-mujor</i>
602	MALLRA DHE SHËRBIME TË TJERA	22,640,000	5,567,839
1	Materiale zyre dhe të përgjithshme	1,140,000	777,080
2	Materiale dhe shërbime speciale	1,165,000	630,137
3	Shërbime nga të tretë	4,225,000	2,037,356
4	Shpenzime transporti	560,000	498,882
5	Shpenzime udhëtimi	630,000	176,027
6	Mirëmbajtje të zakonshme	1,280,000	101,600
7	Shpenzime për qiramarrje	1,700,000	952,000
8	Shpenzime te tjera operative	11,940,000	394,757

Gjatë këtij 8-mujori të parë të vitit 2024, janë kryer pagesa për të shlyer detyrimet bazuar në kontratat dhe faturat, sipas procedurave përkatëse. Shpenzimet janë realizuar për pagesat e detyrimeve utilitare dhe detyrime prioritare: si energji elektrike; ujë; shërbime postare; si dhe taksa blerje karburanti; shlyerja e detyrimeve kontraktuale; prokurimet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

2.1.3.1 Materiale zyre dhe të përgjithshme

Në këtë nënartikull buxhetor përfshihen shpenzimet materiale për kancelari, materiale higjeno-sanitare, materiale elektrike, dhe artikuj si këto. Plani i buxhetit për këtë zë është 1.14 milionë lekë, nga i cili është përdorur një fond prej rreth 0.78 milionë lekë për të likuaduar faturat për shpenzimet materiale si kancelari, materiale higjeno-sanitare, etj.

Fondi i mbetur do të përdoret në muajt në vijim për likuidimin e faturave për blerjen e kancelative (është mbyllur procedura e prokurimit dhe do të kryhet pagesa brenda muajit shtator) dhe materialeve të pastrimit të cilat do të prokurohen në muajin shtator.

2.1.3.2 Materiale dhe shërbime speciale

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzimet lidhur me abonimet në shtypin e shkruar, regjistra specifike të protokollit, kodekse, uniforma për seancat gjyqësore, dizinfektim ambientesh, e të tjera specifike. Nga 1.165 lekë milionë të planifikuara janë përdorur rreth 630 mijë lekë, ose 54% .

Në këtë zë, peshë të madhe zënë nevojat për kuti dhe dosje, për vendosjen e dokumentacionit të institucionit të klasifikuar me afat ruajtje të përhershme, pas përpunimit të tyre. Procedura e prokurimit për kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme po kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, bazuar në VKM nr. 360, datë 26.04.2017, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave” ndryshuar me VKM nr. 608, datë 22.09.2022.

Gjatë muajit shtator do të kryhet pagesa për blerjen e regjistrave dhe uniformave.

2.1.3.3 Shërbime nga të tretë

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzimet që në përgjithësi janë utilitare, si energji elektrike, furnizim me ujë, shpenzime postare (postim dokumentacioni, abonim në shtypin e shkruar), telefoni fikse, si dhe publikime në media të vendeve të shpallura vakante në institucion. Nga 4.225 milionë lekë të planifikuar, janë realizuar rreth 2.037 milion lekë ose 48%. Edhe në këtë nënartikull pritet që realizimi të jetë më i lartë në fund të muajit shtator pasi të jetë kryer pagesa për shërbimin e printimit, i cili zë një peshë të konsiderueshme të fondeve të dedikuara për këtë kategori shpenzimesh.

2.1.3.4 Shpenzime transporti

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzimet që lidhen me pjesët e këmbimit të makinave, goma bateri, karburantit, vendparkimi për automjetin e Kolegjit, si dhe siguracioni i detyruar i automjetit. Fondi për këto zëra është përdorur në varësi të nevojave që ka pasur riparimi ose mirëmbajtja e automjetit. Nga 560 mijë lekë të planifikuara janë përdorur rreth 499 mijë lekë ose 89%.

2.1.3.5 Shpenzime udhëtimi

Në këtë nënartikull janë kryer shpenzime për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit. Nga 630 mijë lekë të planifikuara për shërbime jashtë dhe brenda vendit, janë përdorur 176 mijë lekë ose 28% për të mbuluar shpenzimet për përfaqësuesit e Kolegjit në “Takimin e 14-të të Nënkomitetit të Stabilizim-Asociimit”.

2.1.3.6 Mirëmbajtje të zakonshme

Në këtë nënartikull janë kryer shpenzime për mirëmbajtje të sistemeve/pajisjeve TIK dhe të sistemit elektrik. Pjesë e këtij fondi është edhe marrëveshja kuadër nr. 519/31 prot., datë 04.08.2023 lidhur midis Kolegjit dhe operatorit ekonomik “Atom” ShPK, me objekt “Mirëmbajtje për servera, kompjutera, pajisje zyre”. Edhe për pjesën e mbetur të vitit 2024 është parashikuar që kryhet procedurë prokurimi për këtë zë, me qëllim sigurimin e vijueshmërisë së shërbimeve.

2.1.3.7 Shpenzime për qiramarrje

Në këtë nënartikull janë kryer shpenzime për qiranë e ambjenteve shtesë dhe janë përfshirë shpenzime që i përkasin kontratës së lidhur gjatë vitit 2023. Janë planifikuar shpenzime në vlerën 1.7 milion lekë dhe janë përdorur 952 mijë lekë për likuidimin e kësteve të qirasë, si dhe 168 mijë lekë të cilat derdhen si tatim në burim. Në total janë përdorur 66% të planit.

2.1.3.8 Shpenzime te tjera operative

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzime për sigurimin e jetës, shëndetit dhe pronës, shpenzime për taksa të ndryshme, licenca Firewall, Microsoft Office dhe Zoom Meeting etj. Procedurat për “Blerje licensash Firewall/Microsoft Office dhe Zoom Meeting” dhe “Mirëmbajtje website kpa.al”, do të zhvillohen në periudhën gusht-tetor, duke marrë parasysh përfundimin e kontratave aktuale. Procedura e prokurimit me objekt “Sigurimi i shëndetit për gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, personat e lidhur të gjyqtarëve, këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, sekretarin e përgjithshëm, drejtorët e drejtorive, stafin administrativ dhe sigurimi i pasurisë”, në zbatim të VKM nr. 245, datë 17.04.2024, është kryhet nga “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” SHA dhe pritet të lidhet kontrata brenda muajit shtator 2024. Pas kryerjes së procedurave të nevojshme, do të vijohet me likuidimin e faturës.

2.1.3.9 Transferta për buxhetet familjare dhe individët (llogaria ekonomike 606)

Buxheti i detajuar në këtë zë është në vlerën 1.25 milionë lekë dhe realizimi në vlerën 441 mijë lekë, ose 35%. Në këtë grup përfshihet fondi i veçantë në vlerën 250 mijë lekë, miratuar me ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, si dhe fondi në vlerën 1 milion lekë për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për gjyqtarët dhe këshilltarët e Kolegjit, transferuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 534 prot., datë 09.02.2024, nga artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” në artikullin 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”.

Gjatë kësaj periudhe është kryer rimbursimi i shpenzimeve telefonike të gjyqtarëve dhe këshilltareve, sipas përcaktimit në VKM nr. 673, datë 02.09.2020, “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 28, datë 21.12.2020, të Mbledhjes së Gjyqtarëve, ndryshuar me vendimin nr. 23, datë 05.02.2021, për vitin 2024, në vlerën 441 mijë lekë.

2.1.4 Shpenzimet kapitale (231)

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2024, në investime është 2 milionë lekë dhe përbën rreth 1% të buxhetit total vjetor të rishikuar. Këto fonde janë parashikuar për plotësimin e nevojave për punonjësit, bazuar në strukturën organike, si dhe të nevojave të tjera të institucionit për pajisje kompjuterike në vlerën 1,2 milionë lekë dhe pajisje e mobilje zyre në vlerën 800 mijë lekë. Sa i takon zërave në investime, në Regjistrin e Parashikimit të Prokurimit Publik për vitin 2024, janë parashikuar për t'u realizuar në pjesën e dytë të vitit.

Në lidhje me sa më sipër, bashkëlidhur gjeni anekset për raportimin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën janar – gusht të vitit 2024.

Duke ju falënderuar për vëmendjen,

3 ANEKS 1 SITUACION I SHPENZIMEVE OPERATIVE 602 PËR 4-MUJORIN E PARË TË VITIT 2024

<i>N/artik</i>	<i>Struktura e llogarive</i>	<i>Plan vjetor</i>	<i>Fakt Prill</i>
602	MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA	22,640,000	5,567,839
	MATERIALE ZYRE DHE TE PERGJITHSHME	1,140,000	777,080
6020100	Kancelari, letër	700,000	547,920
6020200	Materiale për pastrim e higjeno-sanitare	400,000	222,960
6020200	Materiale elektrike, ndriçim etj.	20,000	
6020400	Materiale për funksionimin e pajisjeve speciale	10,000	4,400
6020900	Furnizim dhe materiale tjera zyre dhe të përgjithshme	10,000	1,800
	MATERIALE DHE SHERBIME SPECIALE	1,165,000	630,137
6020100	Uniforma	20,000	
6021003	Ilaçe, materiale dhe proteza mjekësore	5,000	
6021004	Furnizime dhe shërbime me ushqim për mencent	300,000	291,900
6021007	Posta abonim ne shtypin e shkruar	100,000	48,552
6021010	Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik (regjistra etj.)	650,000	
6021099	Dezinfektim i ambienteve	40,000	
6021099	Të tjera materiale dhe shërbime speciale	50,000	50,000
	SHERBIME NGA TE TRETE	3,225,000	2,037,356
6022001	Elektricitet	1,240,000	1,064,806
6022002	Ujë	80,000	55,701
6022003	Shërbime telefonike celulare	960,000	417,307
6022003	Shërbime telefonike fiks	40,000	18,687
6022004	Posta dhe shërbim korrieri	190,000	106,455
6022007	Shërbime bankare	5,000	
6022010	Shërbime të printimit dhe publikimit	500,000	374,400
6022011	Kosto e trajnimit dhe seminareve	150,000	
6022099	Shërbim interneti për ambientet me qira	50,000	
6022099	Shërbime të tjera	10,000	
6022100	Shërbime printimi	1,000,000	
	SHPENZIME TRANSPORTI	560,000	498,882
6023100	Karburant dhe vajra	250,000	232,700
6023200	Pjese këmbimi, goma dhe bateri	50,000	50,000
6023300	Shpenzime figuracioni të mjeteve	60,000	18,182
6023900	Shpenzime të tjera transp (parkim për automjetin e institucionit)	200,000	198,000
	SHPENZIME UDHETIMI	630,000	176,027
6024200	Udhëtim jashtë shtetit.	630,000	176,027
	MIREMBAJTJE TE ZAKONSHME	1,280,000	101,600
6025500	Shpenz. për mirëmbajtje E sistemeve dhe instalimeve teknike	85,000	
6025600	Shpenzime për mirëmbajtje te mjeteve të transportit	100,000	77,600
6025800	Shpenzime për mirëmbajtje e pajisjeve te zyrave	1,095,000	24,000
	SHPENZIME PER QERAMARRJE	1,700,000	1,120,000
6026100	Shpenzime për qiramarrje ambjentesh	1,700,000	1,120,000
	SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE	11,940,000	394,757

6029004	Shpenzime për sigurimin e jetës, shëndetit dhe pronës	10,985,000	106,364
6029006	Shpenzime kompes telefonie për funksionaret e institucionit	80,000	
6029006	Shpenz kompesim për zyrtaret e zgjedhur (pasaporte diplomatike)	60,000	
6029008	Shpenzime për tatim & taksa te paguara nga instit.	50,000	20,393
6029099	Blerje licensash Firewall/Microsoft Office dhe Zoom Meeting	600,000	
6029099	MKZ	20,000	20,000
6029099	Blerje materiale hidraulike, marangozi, ndërtimi etj.	20,000	
6029099	Dekorimi i festave te fundvitit	5,000	
6029099	Mirëmbajtje website kpa.al	120,000	80,000